

Nr. _____ prot

Tiranë, _____._____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Shërbim rezervë (Back-Up) për sigurimin e vazhdimësisë së transportit të seteve dhe materialeve të konsumit sterile dhe jo sterile, transportit të mbetjeve të rrezikshme spitalore që krijohen nga seti i personalizuar, në pamundësi të përkohshme të “OSHIS””*

KODI SIPAS FJALORIT TË PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 600000000-8

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-94629-07-27-2026

FONDI LIMIT TOTAL/VLERA E PRITSHME E KONTRATËS: 159,915,504.36 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e katër pikë tridhjetë e gjashtë) **LEK, pa TVSH ose 1,706,857.77** (një milion e shtatëqind e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e shtatë) **Euro pa TVSH.**

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 27.7.2026 është 93,69 Lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit/pjesëmarrjes” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës e parashikuar e marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri

ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet se: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën (e vlefshme) **ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent** në përputhje e objektin e prokurimit e cila të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të kryer shërbime dhe që janë vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që shërbimi të kryhet me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.3.3 Operatori duhet të disponojë licencë për transportin e mbetjeve spitalore me rrezik biologjik, sipas legjislacionit në fuqi për transportin e këtyre mbetjeve, dhe të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, i cili parashikon: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”;

Gjithashtu mbështetet në nenin 41, pika 4/a, të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”;

Objekti i kësaj procedure përfshin transportin e mbetjeve spitalore, të cilat klasifikohen si mbetje të veçanta dhe potencialisht të rrezikshme për shëndetin publik dhe mjedisin. Për këtë arsye, ushtrimi i këtij aktiviteti lejohet vetëm nga operatorë ekonomikë të licencuar nga autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve dhe mbetjeve spitalore.

Kërkesa për disponimin e licencës garanton që operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht të kryejë transportin e mbetjeve spitalore, disponon kapacitetet teknike dhe organizative të nevojshme dhe respekton standardet e sigurisë, mbrojtjes së shëndetit publik dhe të mjedisit gjatë transportit të tyre.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, proporcionale me natyrën dhe rrezikshmërinë e shërbimit që do të realizohet, si dhe e domosdoshme për të garantuar zbatimin e kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.3.4 Operatori duhet të disponojë minimum 13 automjete. Mjetet të jenë furgon i mbyllur integral me peshë mbajtëse malli nga 1-1.5 ton për të përballuar ngarkesat e ditës si mbetje spitalore, karrelo me sete instrumenta kirurgjikale dhe materiale si sete sterile dhe josterile dhe materiale konsumi. Të ketë 4 dyer, ku dyert e pasme të jenë pa xham, 10 (dhjetë) prej tyre të kenë të pajisura më pedanë për ngarkim shkarkim, sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës, të shërbimit objekt prokurimi.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesin dokumentet e mëposhtme provuese:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi/kontrata qiraje/kontrata huapërdorje/kontratë dhurimi/çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Leja e qarkullimit të mjetit, akt – kolaudimi, Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet, foto të mjeteve ku të duket qartë targa dhe sinjalistika dalluese për transportin e mbetjeve spitalore të rrezikshme.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 4/ç e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë faktin se shërbimi objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK në ambientet e trajtimit të operatorit ekonomik, si dhe transportit të materialeve të buta sterile dhe jo sterile, sete me instrumenta kirurgjikalë drejt Centraleve të Sterilizimit dhe Spitaleve, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën me qëllim ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri i kërkuar i mjeteve është minimal, me qëllim që transporti i konteniereve me mbetje apo karrelot me stete të instrumentave kirurgjikalë, apo materilet e konsumit, të kryhen në mënyrë që të sigurohet integriteti dhe pastërtia e tyre, në përputhje me rregullat e higjienës dhe sigurisë, duke qenë se në specifikimet teknike dhe termat e referencës është e përcaktuar se duhet të sigurohet grumbullimi i konteniereve me mbetje në pikat e përkohshme të magazinimit të autoriteteve shëndetësore si dhe transportin e tyre në impiantin e trajtimit me mjetet e posaçme të transportit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të kenë të punësuar minimumi 14 (katërmbëdhjetë) punonjës të punësuar për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës Përgjegjës shërbimi
- 13 (trembëdhjetë) punonjës shofer
 - Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)/CV
 - Leje Drejtimi

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pra që kanë në dispozicion për përmbushjen e kësaj kontrate.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, termave të referencës, proceset e realizimit të shërbimit objekt prokurimi.

Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e proceseve të shërbimit, si dhe përgjigjet për zbatimin e të gjitha detyrave dhe fazave të shërbimit, në përputhje me specifikimet teknike, termat e referencës, rregullat dhe standartet ligjore të zbatueshme në fuqi.

Numri i punonjësve është vlerësuar i tillë në përputhje me proceset e punës dhe detyrat që do të kryhen, në përputhje me specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.6 Operatori duhet të disponojë Kontratë me kompani që menaxhon sisteme GPS, ose në rastin kur menaxhon vetë sistemin e GPS për monitorimin e sistemit, të dorëzojë Deklaratë me anë të së cilës deklaron se pëmbush kërkesat e AK për konfigurimin dhe raportimin e sistemit GPS.

Argumentimi: Ky kriter vendosen mbështetur në nenin 77, pika 1/c të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, i cili parashikon: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.”

Gjithashtu, kërkesa mbështetet në nenin 41, pika 6 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar i cili parashikon: “6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

Objekti i kontratës përfshin transportin e mbetjeve spitalore, aktivitet që kërkon monitorim të vazhdueshëm të mjeteve gjatë gjithë procesit të transportit, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë së itinerarit, kontrollin e respektimit të rrugëve të miratuara, verifikimin e kohës së transportit dhe mundësinë e raportimit në çdo kohë pranë Autoritetit Kontraktor.

Disponimi i një sistemi GPS funksional, qoftë nëpërmjet një kontrate me një subjekt të specializuar, qoftë nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik, siguron monitorimin në kohë reale të mjeteve dhe mundëson gjenerimin e raporteve të nevojshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Në rastet kur sistemi administrohet nga vetë operatori ekonomik, paraqitja e deklaratës garanton angazhimin për konfigurimin e sistemit dhe sigurimin e aksesit në raportet dhe të dhënat e kërkuara gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.7 OE duhet të paraqesë Autodeklaratë me anë të së cilës të përcaktojë më shumë se një person kontakti për çështje administrative, për të cilët duhet të bëjë me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email). Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve. Stafi (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambjentet e Kontraktuesit dhe të shoqërohet nga përgjegjësi i sallave kirurgjikale dhe/ose përgjegjësi i centraleve dhe/ose përgjegjësi i trajtimit të mbetjeve.

Argumentimi: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të

ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

- *Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 10 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbledhës për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor mund të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht skualifikimi.*
- *Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoriteteve kontraktore për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OSHIS sha, të hartuara nga grupi e punës i caktuar nga titullari e AK, bazuar në nevojat e të cilës, Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit sh.a kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 845, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” Sha (Oshis Sh.a.) për ofrimin e shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit”.

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit, në përputhje me nenin 36 të ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të shërbimeve dhe mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

NJËSIA E PROKURIMIT